Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / www.kmsh.al

DRITA ISLAME

DUKE SHOQËRUAR UDHËTARIN
për në përjetësi

ISSN 2226-7115

Viti XXIX / Nr. 8 / Gusht 2020 / Çmimi: 150 Lekë / www.dritaislame.al

Revista Drita Islame
në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

URTËSI

BOTA JONË

FAMILJA

REFLEKSIONE

PERSONALITETE

www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXIX i botimit
Nr. 8 (451)
Gusht, 2020

ISSN 2226-7115

Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Duke shoqëruar udhëtarin për në përjetësi / Dorian Demetja
6 Dezinfektimi i duhur / Qani Sulku
8 Lajme / Aktivitete

12 Fati është në anën e atij që kërkon fatin / Nuredin Nazarko
14 Njeriu pikësëpari
16 Etika e dhënies së zekatit / Shkëputur nga libri "Ilmihal i zgjeruar"
18 Detyrat ndaj fqinjëve / Senad Maku
22 Sikur vetëm ta dinin? /
24 Allahu, xh.sh., në kuran e ka lidhur alkoolin dhe bixhozin me armiqësi dhe urrejtje, ndërsa shkenca bashkëkohore e ka zbuluar fshehtësinë e kësaj lidhje/ Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

26 Ndjenja e jetës së përtejme në ndërgjegje / Rasim Vrioni
28 Hafiz Qazim Ismaili / Xhemal Balla
30 Lumturia
31 Pyetjet e një ateisti dhe përgjigjet e Imam Ebu Hanifes
32 Edukata familjare / Nadia Lika
36 Këmba – Një kryevepër inxhinierie / Tugrul Cagri Yavuz
38 Gjyshe, çka është Kurani?
39 Mos e zemëro atë që e ke më të shtrenjtë

DUKE SHOQËRUAR UDHËTARIN *për në përjetësi*

Vdekjet e shumta që po ndodhin nëpërmjet sëmundjeve dhe aksidenteve të ndryshme, në veçanti kohët e fundit për shkak të corona virusit, si dhe vdekjet në masë nga shpërthimi i madh në Bejrut të Libanit, na bëjnë të rimendojmë edhe një herë për të. Është i çuditshëm fakti që vdekja është përherë afër nesh, ndërkohë që ne e mendojmë atë gjithmonë larg vetes. Nuk dihet që vdekja të ketë gjuhë, por ç'kuptime madhështore ka groposur ajo në një heshtje të thellë! Varret janë plot me adresat e prindërve, fëmijëve, të dashurve, kushërinjve, shokëve dhe miqve, që e kanë konsumuar jetën e përkohshme! Sa foshnja ajo i përqafoi ende pa e njohur këtë botë, sa fëmijë ajo i zuri në lojë e sipër, e sa të rritur ajo i mori duke qenë të hutuar! Sa e sa njerëz i gdhiu mëngjesi, por nuk i zuri mbrëmja dhe sa njerëz i ngrysi nata, por nuk i zuri mëngjesi!

Vdekja është një moment vendimtar për njeriun, sepse ai në atë çast sheh rezultatin e tij, sikurse sheh edhe atë që e pret në të ardhmen e tij. Njeriut, përmes vdekjes, i hapet një derë që nuk i mbyllet më kurrë. Prej saj askush nuk shpëton dhe çdo krijesë dorëzohet. Shumë njerëz dëshirojnë t'i shmangen vdekjes, por ajo në të vërtetë nuk shmanget prej nesh dhe vjen në kohën e caktuar. Profeti (a.s.) ka paralajmëruar se do të vijë një kohë që umeti do të ketë një sëmundje. I thanë shokët e tij: Cila është ajo sëmundje o i dërguari i Zotit? Tha: "Dashuria për dynjanë dhe urrejtja ndaj vdekjes" (Ebu Daud; Ahmed). Kjo do të thotë që njeriu i sotëm po ndërton në këtë botë dhe të gjitha përpjekjet e tij po i drejton në këtë kahje. Ndërkohë botën e ahiretit e harron, ndoshta me mendimin se një ditë do ta ndërtojë edhe atë, por vitet kalojnë dhe koha merr tatëpjetën. Më pas vjen një kohë kur njeriu me harxhimet e mundin ka ndërtuar pothuajse gjithçka këtu dhe i vjen shumë keq ta braktisë e të shkëputet prej saj.

Një nga misteret më të mëdha dhe më të thella për njeriun, është stacioni i parë në vendbanimin e përjetshëm. Gjithsekush përgatitjen për atje e bën në bazë të besimit që ndjen dhe që aplikon në jetën e përditshme plot sprova. Kultura shpirtërore më me rëndësi e njerëzimit, fillon me zgjidhjen e misterit nën dhè. Po qe se idetë, përpjekjet, kërkimet, thellësitë ndjesore dhe ndjimet e brendshme, nuk mblidhen rreth të vërtetës së vdekjes, e vërteta e këtij vendi misterioz e quajtur "varr", nuk mund të bëhet e qartë. Me të vërtetë, në jetë janë dy kështilluesit më të rëndësishëm për njeriun. Njëri

nga këta flet, tjetri hesht. Këshilluesi që flet është Kurani, ndërsa ajo që këshillon me heshtjen e saj të

thellë, është vdekja.

Duke reflektuar për këtë fenomen, na vijnë ndërmend objektivat e ndryshme afatgjata dhe afatshkurtra të njeriut, i cili me këmbëngulje punon dhe përpiqet në realizimin e tyre, gjithmonë për një jetë më të mirë, më komode dhe më të rehatshme. Kjo, duke filluar nga pranimi në një universitet të mirë, mbarimi i tij me sukses me mendimin

për master, gjetja e një pune të mirë, martesa me një bashkëshorte të denjë për të, krijimi i familjes duke vazhduar me arsimin e edukimin e fëmijëve në vite etj... Allahu i Madhëruar i ka siguruar të gjitha kushtet për jetesë dhe i ka dhuruar njeriut shumë mirësi, pavarësisht se kjo botë ku ne jetojmë është kalimtare dhe vitet e jetës sonë këtu janë të kufizuara. Të gjitha këto, Allahu i bën që të fitojë dashurinë e krijesave dhe që të njihet prej tyre.

Mëshira e Allahut është e pafund dhe mëshira që paraqet Ai në këtë botë, është vetëm një pjesë e vogël e mëshirës së Tij. Prandaj, asnjë të mos dyshojë në mëshirën e Allahut, sepse është Ai që do t'i shpërngulë krijesat në një botë të përjetshme, në një "atdhe" ku do t'i kënaqë me flladet e mëshirës së Tij dhe në Xhenetin e përjetshëm. I madhëruari Zot, ka përgatitur atje kopshte plot me fruta, livadhe me lule e gjelbërim, ujëvara e lumenj...begati e mirësi që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe as mendja nuk i ka menduar. Bukuritë e kësaj bote janë vetëm shembuj të thjeshtë që shërbejnë për t'i tërhequr vëmendjen njerëzve.

Në këtë gjithësi, përparësi ka jeta dhe cilësia kryesore e jetës është shpirti. Më i lartësuari prej krijesave që kanë shpirt është njeriu. I gjithë universi është i gjallë dhe punon për njeriun, kurse gjallesat e tjera janë dërguar që ta ndihmojnë dhe t'i shërbejnë atij. Njeriu në veten e tij që nga lindja, përmban dashuri ndaj Krijuesit, por edhe Krijuesi e do dhe ka krijuar të gjitha këto mirësi që të fitojë dashurinë e tij. Qëllimi i aftësive dhe i cilësive shpirtërore të njeriut është jeta e përjetshme. Zemra e njeriut e do jetën e përjetshme me gjithë fuqinë e saj, dhe gjuha e tij i lutet Krijuesit për jetën e përjetshme. Pra, Allahu Fuqiplotë, nuk do t'i mbysë përjetësisht njerëzit, Ai nuk do që ata të hidhërohen duke menduar se kanë vetëm jetën e kësaj bote, sepse jeta këtu është vetëm një preokupim dhe shqetësim. Allahu i Madhëruar i mundëson njeriut jetën e kësaj bote, në mënyrë që ai të fitojë provimin e ditës së fundit dhe të përjetojë lumturinë përrallore në Xhenet.

Për këtë, i lutem Zotit me përgjërim: Të gjitha shkaqet kanë heshtur. Asnjë ngjarje nuk mund të ndikojë në rrjedhën e natyrës dhe askush nuk mund të më zgjasë dorën dhe të zgjidhë hallet e mia. Unë i ngrita duart dhe po i lutem Atij, më të Madhëruarit, Atij që vazhdimisht zërin ma dëgjon, frymëmarrjen ma ndjen, Atij, i cili më thotë se është më afër se damari im i qafës: "O Strehuesi i të pamundurve! O Burim fuqie për të dobëtit! O Shërues i të brengosurve! O Orientues i të humburve! O Fuqiplotë i Përjetshëm që i përgjigjesh çdo lutjeje! Paqja dhe shpëtimi janë tek Ti, dobia dhe begatia Jote janë pambarim. Kërkojmë prej Teje falje dhe largimin e së keqes prej nesh në këtë botë dhe në tjetrën. Na bëj njerëz të plotësuar nga ana trupore, mendore dhe shpirtërore. Bashkë me dijen na shto pasurinë e zemrës dhe pastërtinë e shpirtit".

Dezinfektimi i duhur

Jetojmë në një kohë kur flitet shpesh për dezinfektim dhe dezinfektues, madje këshillohet qe të mbahet me vete kudo ku shkon, dhe të lyhesh me atë solucion në mënyrë që të ruhesh dhe mbrohesh nga viruset. Në fakt, një lloj tjetër dezinfektimi dhe dezinfektanti është më i dobishëm dhe më me vlerë, me të cilin duhet të pajiset secili njeri, e në mënyrë të veçantë çdo besimtar që dëshiron dhe synon të rezultojë i pastër dhe qelibar nga mëkatet, ditën kur do të paraqitet para Zotit të Lartësuar.

Përderisa jemi njerëz, edhe gabojmë, ku më shumë e ku më pak, por nuk jemi të imunizuar nga gjynahet. Diku mëkate të vogla e diku tjetër mëkate që peshojnë rëndë. Allahu, i Cili na krijoi, sigurisht që është i Vetëdijshëm për natyrën njerëzore që mund të bie në mëkate, ashtu siç ra edhe i pari i njerëzimit - Ademi a.s. bashkë me bashkëshorten e tij. Allahu na ka orientuar drejt detergjentëve më efikasë ndaj mëkateve, pasi siç dihet, çdo gjynah shënon një njollë të zezë në zemrën tonë, e ajo nuk hiqet pa u shplarë mirë e mirë me një ilaç të fuqishëm pastrimi. Ashtu siç kujdesemi për pastërtinë e trupit dhe të rrobave që veshim; ashtu siç kujdesemi për të evituar çdo papastërti dhe njollë të dukshme në trupin tonë dhe veshjen tonë, kujdes shumë herë më të madh duhet të tregojmë ndaj njollave që i përveshim zemrës, nëpërmjet veprimeve tona të pakontrolluara mirë paraprakisht.

Një zemër, edhe pse mund të pulsojë në kraharorin e dikujt, ajo konsiderohet e vdekur nëse është e mbuluar totalisht nga njolla të zeza të shkaktuara nga mëkatet e njëpasnjëshme të një robi të shkujdesur. Për fat të keq, sa e sa zemra të tilla strehohen në trupa njerëzish që lëvizin mbi tokë. Është më se e domosdoshme që të njihemi me disa prej dezinfektuesve më adekuatë për fshirjen e mëkateve tona; me disa stacione pastrimi e lavazhi, ndër të cilat mund të veçojmë: Pendimin, Istigfarin dhe punët e mira. Më i miri prej gabimtarëve është ai që pendohet për gabimin e bërë, dhe ai që pendohet është sikurse nuk ka bërë gabim. Vetja jonë e tillë është, na shtyn dhe na cyt gjithmonë drejt të ndaluarës, por ndërgjegja e kultivuar me besim, frikë dhe shpresë tek Allahu na bën që të reflektojmë pas çdo gjynahu dhe të pendohemi sinqerisht para Pranuesit të pendimeve – Allahut të Lartësuar. Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen nga mëkatet e tyre. Kështu thotë vetë Ai në librin e Tij, në Kuran. Kur dëgjon këtë verset kuranor, edhe ai që është i ngarkuar me gjynahe plot, mbushet me shpresë se Allahu do ta falë e do ta mëshirojë dhe nxiton të pendohet e të bëjë kthesë në jetën e tij.

Mëkatet nuk i fal askush tjetër përveç Allahut, prandaj Atij i duhet drejtuar me istigfar (kërkim-falje) gjatë ditës e natës. Allahu është Ai që thërret çdo ditë: A ka dikush që kërkon falje dhe Unë ta fal; A ka dikush që dëshiron të pendohet dhe Unë t'ia pranoj pendimin. Eh çfarë bujarie të pakufishme ka i Madhi Zot për krijesën e Tij më të dashur. Ai nuk mërzitet kurrë nga lëshimet

tona në veprime për aq kohë sa ne i drejtohemi vetëm Atij për falje dhe pendim.

Punët e mira i fshijnë punët e liga, kështu që pasoje punën e keqe me një të mirë, duke shpresuar që Allahu do të ta shlyejë të keqen e do të ta zëvendësojë atë me të mirën që bëre. Renditja që i bëra tre detergjentëve të lartpërmendur nuk është e rastësishme, por janë hapat që duhen ndjekur për largimin e papastërtisë dhe njollave që shkaktojnë gjynahet. Nuk parandodh që një mëkatari, Allahu t'ia hapë dyert e mirësisë pa u penduar më parë tek Ai, e pendimi e shpie robin drejt të kërkuarit falje, ndërsa falja e nxit njeriun për të bërë punë të mira e të dobishme, me nijet të pastër e me qëllim që me to të largojë të këqijat që veproi, si dhe të fitojë kënaqësinë e Allahut.

Prandaj o rob i Zotit, nxito sa më parë të pastrosh veten nga gjynahet që të rrethojnë, sepse nuk i dihet se kur del nga kjo botë; përgatitu seriozisht që ta takosh Zotin me zemër të bardhë, ashtu siç do mbulohesh me qefin të bardhë ditën që do të rrugëtosh nga kjo dynja për në botën e amshuar.

1 FALJA E KURBAN BAJRAMIT

Besimtarët myslimanë falën namazin e Kurban Bajramit në të gjitha xhamitë e vendit.

Ceremonia kryesore, ku ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu u zhvillua në xhaminë e "Kokonozit" (Pazari i ri), Tiranë.

Ashtu si falja e Fitër Bajramit edhe Kurban Bajrami këtë vit u zhvillua në të gjithë vendin duke respektuar një protokoll të caktuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Në përfundim të kësaj ceremonie, besimtarët e pranishëm shkëmbyen mesazhe të shumta urimi ndërmjet tyre. Ndërkohë e njëjta atmosferë festive ka shoqëruar faljen e Kurban Bajramit në çdo xhami të vendit.



2 VIZITA E KRYETARIT NË KËSHILLIN E KOMUNITETEVE MUSLIMANE BOTËRORE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga Rektori i Universitetit Bedër, Prof. Dr. Ferdinand Gjana dhe Këshilltari për Marrëdhëniet me Botën Arabe, z. Xhemal Saferti zhvilluan një vizitë zyrtare në Këshillin e Komuniteteve Muslimane Botërore me seli ne Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Kreu i KMSh-së gjatë vizitës së tij u prit në takim nga kryetari i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Dr. Ali Rashid Al-Nuaimi.

Më pas Kreu i KMSH-së ka zhvilluar disa takime të tjera me Drejtorin e Përgjithshëm të Çështjeve Islame dhe Vakfeve në EBA, z. Muhamed al-Nijadi dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Komuniteteve Botërore Myslimane, z. Muhamed el-Beshari.

3 KMSH SHPËRNDAN QINDRA PAKETA ME MISH KURBANI

Komuniteti Musliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Medresenë e Tiranës kanë realizuar bërjen dhe shpërndarjen e mishit të kurbaneve tek qindra familje.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon drejtuesit e komuniteteve myslimane dhe besimtarët shqiptarë të Albanian American Muslim Community në Connecticut, USA, xhaminë Reinach Aargau në Zvicër, Bashkësinë Kulturore Islamo Shiptare Flums ne Zvicër, xhaminë El-Hidaje në Zvicër, Xhamia Shqipëtare në Hamburg të Gjermanisë, Qendra kulturore Shqipëtare në Vienë të Austrisë dhe të gjithë besimtarët që kanë dhuruar kurbane pranë KMSH-së.

Gjithashtu bërja dhe shpërndarja e mishit të kurbanit është realizuar nga myftinitë edhe në rrethe të tjera të vendit.

4 KRYETARI I KMSH-SË VLERËSOHET ME CERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, u vlerësua nga Kryetari i Bashkisë së Lushnjes, z. Fatos Tushe me Certifikatë Mirenjohjeje me motivacionin: "Për kontributin e madh që ka dhënë duke iniciuar dhe mbështetur investime të shumta në interes të komunitetit të Lushnjes. Vepra e tij humanitare, sidomos me çeljen e Qendrës Multifunksionale të aftësimit profesional, tregon dashurinë e veçantë të z. Spahiu për brezin e ri".

Ky vlerësim iu dorëzua Kryetarit Spahiu gjatë inaugurimit të qendrës kulturore të Myftinisë së Lushnjes

5 INAUGUROHET QENDRA KULTURORE FETARE NË LUSHNJE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Drejtorin e Vakf-Investimeve z. Edison Hoti, morën pjesë në inaugurimin e qendrës kulturore të Myftinisë së Lushnjes.

Në këtë ceremoni ishin gjithashtu të pranishëm Myftiu i Lushnjes, z. Gramoz Blliku, Kryetari i Bashkisë së këtij qyteti z. Fatos Tushe, Kryetari i Shoqatës "Mirënjohja" z. Samed Shehu si dhe dhjetëra besimtarë.

Qendra u financua nga shteti i Kuvajtit nëpërmjet Fondacionit "Mirënjohja".

6 INAUGUROHET XHAMIA E RE E FSHATIT BANAJ, BERAT

Ceremonia e inaugurimit të kësaj xhamie, ku ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Drejtori i Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, Myftiu i Beratit, z. Bafjar Këllezi, Myftiu i Lushnjës, z. Gramoz Blliku, Kryetari i Fondacionit "Mirënjohja", z. Samed Shehu si dhe dhjetëra besimtarë të zonës, nisi me leximin e disa ajeteve Kuranore.

Për të vijuar më pas me fjalën hapëse të Myftiut të Beratit, kryetarit të KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Kryetarit të Fondacionit "Mirënjohja" z. Shehu të cilët u shprehën mjaft mirënjohës për kontribuuesit dhe theksuan se xhamitë janë vatra ku formohen qytetarë dhe individë me vlerë për shoqërinë.

FATI është në anën e atij që kërkon FATIN

Njeriu ka natyrë kurioze. Ajo që ndez shkëndijën e kuriozitetit dhe hulumtimit është e panjohura derisa të bëhet e njohur. E panjohura më intriguese mbetet e ardhmja. Për të njohur të ardhmen plot njerëz rendin drejt atyre që pretendojnë se lexojnë të ardhmen përmes shenjave të caktuara të dorës, natyrës apo pretendimeve se flasin me botën e shpirtrave. Edhe pse janë po njerëz, njerëzit që kërkojnë të ardhmen sikur magjepsen prej pretendimit të tyre dhe nuk ngurrojnë aspak t'i kërkojnë ku janë e ku s'janë, të paguajnë edhe para tek këta individë vetëm e vetëm që të arrijnë të njohin ndonjë çështje të së ardhmes së tyre. Njerëzve iu duhet kujtuar diçka tepër e rëndësishme në këtë çështje. Kujtesa vjen si pasojë e harresës.

E ardhmja i është fshehur njeriut për të mirën e tij. Le të përfytyrojmë për një çast sikur do të njihte çdokush të ardhmen e vet. Paskëndaj jeta do të ishte një torturë e vërtetë, pasiqë kjo e ardhme nuk do të mund të ndryshohej. Shpresë nuk do të kishte. Ëndrra nuk do të kishte. Mendim se çfarë do të bëj më mirë dhe si e qysh do të përmirësoj veten nuk do të ketë. Duke mësuar sfidat, vështirësitë, fatkeqësitë, shpirti do të rëndohej prej shqetësimit dhe dëshpërimit. Elani jetësor do të thahej dhe jeta do merrte vetëm një ngjyrë. Njohja e së ardhmes do të ishte tortura më e madhe për qenien njerëzore. Për të qënë më e bukur jeta njeriu nuk mund ta njohë të ardhmen e vet, apo fatin e vet. Nëse njerëzit që pretendojnë se njohin të fshehtën e së ardhmes të jetëve njerëzore do ta njihnin vërtet të ardhmen, atëherë do të shpëtonin si fillim vetet e tyre nga fatkeqësitë që do t'iu ndodhnin. Përderisa jetët e tyre janë ashtu si të gjitha jetët njerëzore, si mund t'u besohet këtyre njerëzve njohja e së ardhmes të jetës së të tjerëve?

Fati mbetet i panjohur derisa të zbulohet dhe të kthehet në përvojë historike të njeriut. Në çastin që kthehet në përvojë historike njeriu nuk shqetësohet më për të rendur tek njohësit e së ardhmes. Ajo çfarë i jep shtysë dhe forcë njeriut për të realizuar përgjegjësitë jetësore është pamundësia për të njohur fatin. Në të kundërt energjia do të shterej dhe njeriu do të kthehej në krijesë vegjetative në pritje të ndodhjes së ngjarjeve jetësore pa lëvizur aspak. Sado i fortë të jetë kurioziteti për të njohur të ardhmen, pamundësia e njohjes së saj është fakt i pamohueshëm dhe njeriu i dorëzohet fatit. Njeriu mund të ndërtojë përfytyrime nga më të bukurat se si do të jetë jeta e tij, por asnjëherë jeta nuk rrjedh sipas planeve që harton. Gjithmonë do të ndodhë një ngjarje e paparashikuar nga mendja njerëzore që jep ndikime të forta se si do të jetë rrjedha e mëpasme e jetës. Ky është fati që njeriu i dorëzohet si dëshmi e pafuqisë së tij për të kontrolluar jetën e vet me detaje.

Njeriu me kuriozitetin e vet eksploron në hapësirat e imagjinatës se sa do të jetë e mundur të përputhen planet e tij me fatin. Për këtë lodhet, punon, sakrifikon. Pavarësisht se rezultatet e punës nuk do të jenë gjithmonë në përputhje me pritshmërinë që ka njeriu, kënaqësia që merr nga puna e kryer është një nga pjesët e rëndësishme që ngjyros jetën e tij. Pa lodhje dhe sakrificë për të realizuar përgjegjësitë jetësore as jeta nuk mund të quhet e plotësuar. Në të kundërt do të duhej të kishim zili dembelët.

Njeriu që kërkon të plotësojë jetën e vet me drejtësi, ndershmëri e dinjitet është gjithmonë i etur për të kërkuar fatin e tij. Vazhdimisht është në lëvizje për të mos u qelbur nga dembelizmi. Surprizat e fatit i mirëpret dhe me kurajo përpiqet të harmonizojë pasionet e tij me atë që i solli fati. Nuk bëhet pesimist. Buzëqeshja nuk ndahet prej fytyrës edhe në ditët e vështira. Durimi dhe zgjedhjet për ta përballuar jetën në krah të së drejtës janë bashkëshoqëruesit. Nuk ndihet i zhgënjyer prej fatit, pasi është i bindur se përtej vështirësive ka mirësi të cilat presin t'i bashkohen dhe t'ia zbukurojnë jetën. Pasioni dhe vullneti për të arritur qëllimin madhor, jetë sipas parimeve të epërme, nuk i mpaken, as nuk i ligështohen. Përkundrazi me vullnet përparon drejt mirësisë e drejtësisë edhe më shumë. Ky është njeriu me të cilin edhe fati buzëqesh teksa e vështron sesi ecën drejt tij. Ky është njeriu që kërkon takimin me fatin e tij dhe fati i tij kërkon takimin me të.

Njeriu pikësëpari

Gjatë një udhëtimi me aeroplan, pranë meje ishte ulur një i ri i huaj, në fytyrën e të cilit dukeshin qartë shenja mërzie, stresi dhe vetizolimi nga të tjerët. Ai dukej sikur i frikësohej kujtdo që kërkon t'i ulet pranë, që orvatet t'i flasë ose t'i japë dorën, e që mund t'i drejtojë pyetjen se çfarë problemi ka që ndihet ashtu.

Në xhepin e ndenjëses përballë tij, ai kishte zhytur kokën në kërkim të diçkaje çfarëdo, që e bënte të dukej i zënë, me qëllim që të tjerët të mos e shqetësonin.

Në imagjinatën time më erdhi ky i ri i kyçur në një shtëpi dhe i prangosur në vargonj të hekurt, por, për të depërtuar në këtë shtëpi, fillimisht të lipsen çelësat e saj.

Me këtë person ndoshta mund të të lidhë ortakëria në biznes, një projekt, një aktivitet kulturor, ose dëshiron t'i flasësh dy fjalë të mira, ta mbrosh nga një e ligë, ose të zbulosh diçka të hajrit tek ai për të arritur diku tjetër, ose për t'i ofruar një shërbim të nevojshëm.

Por le t'i lëmë mënjanë këto, më e pakta, ai është një bashkudhëtar, me të cilin ti do të ndash lodhjen e udhëtimit të gjatë.

Ai mund të jetë një person i kamur, një gjeni, një studiues, por edhe një pervers, dallaveraxhi, lypës, apo çfarëdo tjetër.

Në fund të fundit, ai mbetet njeri, çfarëdo cilësie t'i faturojmë. Ditën që ka lindur, ka lindur i bardhë (tabula rasa).

"Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues." (Nahl, 78)

"(Allahu do t'u thotë:) "Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë.." (En'am, 94)

Çdo orvatje komunikimi që e kapërcen parimin e humanizmit, është e destinuar të dështojë. Fatmirësisht, edhe ti je njeri, ke goxha informacion të detajuar dhe aktual rreth njeriut, nevojave të tij jetësore, emocioneve, ndjenjave dhe botës së tij të brendshme.

Është urtësi e Zotit që profetët dhe të dërguarit e Tij, t'i zgjidhte prej racës njerëzore, të barabartë me njerëzit e tjerë; ushqeheshin si ata, lëviznin lart e poshtë, martoheshin, lindnin fëmijë, sëmureshin dhe shëroheshin, prekeshin nga fatkeqësitë, etj.

Çdo njeri ka barrierat dhe muret e veta të cilat assesi nuk duhen shembur dhe nuk duhen kapërcyer. Çdo njeri ka portat hyrëse tek të cilat nuk mund të shkelet veçse duke mbajtur në dorë çelësin e zemërbutësisë, etikës dhe mirësjelljes.

Profeti Muhamed (a.s.) u pati thënë dikur shokëve të tij: "Kushdo që synon t'i shmanget zjarrit dhe të fitojë xhenetin, le të bëjë çmos që kur t'i vijë vdekja, të besojë në Zotin dhe botën tjetër, gjithashtu të sillet me njerëzit ashtu siç dëshiron të sillen me të." (Muslimi)

Me këto fjalë,

Profeti (a.s.) po përshkruante një linjë të mrekullueshme në komunikimin e myslimanit me të tjerët. Ai na kërkon që ta vëmë veten në vendin e personit që kemi përballë, teksa komunikojmë me të, të dimë se çfarë i pëlqen dhe e bën të ndihet mirë.

Padyshim, atij i pëlqen t'i bëhen komplimente dhe të lëvdohet. Kushdo që ecën mbi faqen e tokës, gëzon cilësi dhe tipare të mira, për të cilat mund ta vlerësojmë me sinqeritet, pa pasur nevojë të shtiremi.

Atij i pëlqen dhe e gëzon nëse i shpreh simpatinë dhe vlerësimin tënd. E si të mos shfaqësh simpati dhe vlerësim për një njeri të cilin Zoti e ka nderuar dhe pajisur me dinjitet, e ka zgjedhur dhe frymëzuar drejt të mirës?! Zoti thotë në Kur'an: "Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar." (Isra, 70)

"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s.). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe." (Fatir, 32)

"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer." (Tin, 4)

Shikoje në sy,

buzëqeshi me çiltërsi, shtrëngoja dorën me ngrohtësi, foli me fytyrë të çelur dhe zgjidh fjalët e bukura dhe magjike.

I buzëqesh mikut para se brenda të hyjë

Bereqeti shtohet dhe sofra mbushet plot.

Jo, nuk është te sofra bereqeti i tij

Por te fytyra plot nur që e priti sot.

Para se t'i japësh para, t'i plotësosh nevojat dhe t'i gjendesh kur të kërkon, ji bujar me fytyrën tënde, zemrën, respektin dhe vlerësimin. "Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje..." (Bekare, 263)

Bëje këtë me personin me të cilin ke vendosur të kalosh jetën, bëje me fëmijën tënd, i cili ka dalë prej teje dhe tashmë është një qenie e pavarur me personalitetin, strukturën fizike dhe përgjegjësinë e plotë, si në këtë botë, ashtu dhe në tjetrën.

Bëje me kolegun tënd në punë, ortakun në biznes, fqinjin me të cilin takohesh çdo ditë...

Bëjë edhe me shërbëtorin apo shoferin, larg shpërfilljes së humanizmit apo personalitetit të tij. Mos harro se, nëse Zoti të ka privilegjuar në këtë botë me pasuri apo poste, ai mund të privilegjohet në botën tjetër me besim, vepra të mira dhe sinqeritet.

Bëje këtë edhe me një të huaj, të cilin

e sheh për herë të parë. Ku i dihet, ndoshta nuk do e shohësh më kurrë, prandaj lër një përshtypje të mirë për veten, ose për grupin me të cilin identifikohesh. Jepi shansin të krijojë një mbresë të mirë, pse jo, edhe të të xhelozojë. Dërgoji mesazhe optimizmi, se kështu fiton edhe kënaqësinë e Zotit, i cili do ta shpërblejë me diçka më të mirë. Ai që jep, përfiton më shumë se ai që merr. Ahireti ka grada më të larta dhe privilegje më të shumta.

Bëje këtë në radhë të parë me ata njerëz të cilët dëshiron t'i orientosh, kritikosh apo këshillosh për t'i mbrojtur nga ligësitë. Shfaqe simpatinë dhe dhembshurinë tënde për ta, por shmang akuzat dhe çdo formë shtirjeje apo dhe dëshire për t'i pasur nën kontroll. Në të kundërt, ke vulosur dështimin para se t'ia fillosh. Imam Ahmedi thoshte: "Rrallë ndodh që ta zemërosh dikë, e (pastaj) ta dëgjojë fjalën."

Të gjithë atyre që janë në frontin e mësimdhënies, ftesës dhe reformës, u dhurojmë këto pak fjalë që thamë, të cilat burojnë nga thellësitë e përvojës sonë e që përkojnë me Kuranin fisnik dhe udhëzimin profetik. E lus Zotin të na pajisë me urtësi dhe pishtarë drite në këtë botë, duke na mbrojtur nga e liga e veteve tona!

ETIKA E DHËNIES SË Zekatit

Meqë zekati, para së gjithash dhe mbi të gjitha, është adhurim ndaj Allahut xh.sh., nga dhënësi i zekatit përveçse kërkohet zbatimi i këtij detyrimi, ai duhet që gjatë dhënies së tij t'i përmbahet etikës fetare dhe njerëzore. Andaj, i pasuri, i cili jep zekat, duhet të përkujdeset për këto çështje.

1. Gjatë dhënies dhe pas dhënies, zekati nuk duhet të shoqërohet dhe përcillet me fjalë lavdëruese, krenuese dhe përbuzëse, sepse kështu dëmtohet shpërblimi i adhurimit të zekatit dhe dëshmon dyfaqësinë e dhënësit të tij. Allahu xh.sh. në Kuranin Famëlartë thotë:

"O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson Allahun dhe as botën tjetër." (El Bekare: 276)

2. Shumica e dijetarëve islamë janë të mendimit se dhënia e zekatit, në mënyrë të fshehtë, është më e preferuar për shkak se shmang lavdërimin, krenarinë dhe dyfaqësinë e atij që jep zekatin, si dhe nënçmimin apo turpin e atij që pranon të marrë zekatin. Ky mendim mbështetet në ajetin kuranor, në të cilin Allahu xh.sh. ka thënë:

"Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai jua largon (me punë të mira) të këqijat." (El-Bekare: 271)

Gjithashtu, ky mendim ka mbështetje edhe në hadithin e Profetit a.s., ku thuhet:

"Një njeri që jep sadaka dhe e fsheh atë aq sa nuk e di e majta e tij se çka jep e djathta." (Buhariu)

Nga ky rregull bën përjashtim vetëm nëse duhet të jepet zekati haptas me qëllim të nxitjes së të tjerëve, që të japin zekatin.

3. Zekati të jepet nga pasuria e mirë, e shëndoshë dhe nga ajo që është më e dashur për të, e jo nga pasuria e dobët apo që është e dalë nga shpërdorimi. Allahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që u dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranonit për vete vetëm symbyllas. E, dijeni se Allahu s'ka nevojë për ju, është i madhëruar." (El Bekare: 271)

Kjo dispozitë vlen për atë që e jep zekatin, kurse, kur është fjala për marrjen e zekatit nga mbledhësi i zekatit, atëherë ai merr nga pasuria e mesme, as më të mirën e as më të dobëtën.

4. Të shpejtuarit në dhënien e zekatit, sepse të shpejtuarit në këtë çështje nënkupton të shpejtuarit në urdhrin e Allahut xh.sh. dhe, në anën tjetër, mbyllje e portës së depërtimit të djallit për të futur vesvesin apo hipokrizinë në zemrën dhe shpirtin e atij që jep zekat.

Të shpejtuarit në dhënien e zekatit pas plotësimit të kuotës pasurore është me mendimin e shumicës së juristëve islamë, porse dhënia e zekatit edhe para plotësimit të vitit është e lejuar, madje edhe nëse jepet disa vite përpara, veçanërisht kur këtë e kërkon nevoja. Ky është mendimi i Imam Ebu Hanifes dhe Imam Shafiut.

5. Dhënësi i zekatit është mirë që të bëjë përpjekje që zekatin e tij t'ia japë atij që e meriton atë, si p.sh. të jetë i devotshëm dhe zbatues i normave të Islamit, të jetë i ditur apo kërkues i diturisë, të jetë nga ata që e fshehin varfërinë, të jetë nga të afërmit e tij, apo prej atyre që janë shumë nevojtarë për shkak të sëmundjeve të ndryshme.

Rënia e zekatit me vdekjen e pronarit të pasurisë

Nëse një person, i cili ka pasur pasuri dhe i ka plotësuar kushtet e zekatit, nuk e ka dhënë zekatin dhe ka vdekur para se të ketë pasur mundësi të japë zekatin, dijetarët e shkollës juridike hanefite janë të mendimit se për atë bie detyrimi i dhënies së zekatit, me përjashtim nëse ka lënë testament që të jepet zekati. Nga kjo nënkuptohet se nëse një person, i cili ka vdekur pa e dhënë zekatin, nga ai bie detyrueshmëria, sepse zekati është adhurim që ka nevojë për nijet, e me vdekjen e tij, bie edhe detyrueshmëria. Kjo nuk nënkupton se ai do të lirohet nga përgjegjësia para Allahut xh.sh., e nëse i vdekuri nuk ka paguar zekatin, por ka lënë testament për dhënien e zekatit, atëherë trashëgimtarët e tij e kanë për detyrim që ta paguajnë me 1/3 e pasurisë së lënë.

Shkëputur nga libri 'Ilmihal i zgjeruar"
Botim i tre komuniteteve fetare.
Tiranë – Prishtinë – Shkup, 2018.

Detyrat ndaj fqinjëve

Allahu xh.sh. në Kur'anin e Madhërishëm thotë: "Adhuroni vetëm Allahun, e mos i shoqëroni Atij asgjë. Ndaj prindërve silluni mirë, ndaj farefisit, jetimëve, të mjerëve e të varfërve, fqinjit, të afërm (nga gjaku) e tuaj, me të vërtetë Allahu nuk e do çdo mendjemadh që krenohet". (Nisa, 36)

Kush thellohet pak në esencën e ajetit të sipërcituar, e kupton se Allahu xh.sh., krahas urdhrit me të cilin kërkon që vetëm Atë ta adhurojmë e Atij t'i bëjmë ibadet, në të njëjtën kohë, pos të tjerash, kërkon që t'u bëjmë mirë fqinjëve tanë.

Njeriu është qenie shoqërore, andaj edhe sipas ligjeve natyrore, edhe sipas atyre shoqërore, detyrohet për një jetë të përbashkët dhe marrëdhënie të përbashkëta me njerëzit e tjerë, në rend të parë pas familjes së tij, me fqinjët e vet pa marrë parasysh cilës feje, kombësie, fisi, race i përkasin.

Fqinji ndaj fqinjit duhet të jetë i mirë, fisnik dhe i kujdesshëm në çdo pikëpamje. Ky është urdhri që ka ardhur nga burimi i së vërtetës, nga Allahu xh.sh. Ndërsa ai që më vetëdije e me qëllim bën mëkat rreth të drejtave të fqinjit të tij, ai gjithsesi do të shijojë dënimin e rëndë në jetën e ardhme, në Ahiret.

Muhamedi a.s. shpeshherë, gjatë misionit të tij, ua tërhiqte vërejtjen shokëve të vet që të kishin kujdes të madh ndaj të drejtave të fqinjëve, ngase ajo i qe urdhëruar nga vetë Allllahu xh.sh. Ibn Omeri dhe Aishja r.a. tregojnë se i Dërguari i Zotit në një rast ka thënë:

"Asnjëherë nuk më ka ardhur Xhibrili e të mos më ketë porositur të kem kujdes për të drejtat e fqinjit, më në fund fillova të mendoja se atë do ta radhiste ndër trashëgimtarë të ligjshëm".

Shtrohet pyetja se kush konsiderohet fqinj, pasi shumica prej nesh e konsiderojnë për fqinj vetëm atë që banon ose jeton drejtpërdrejt, në afërsi të shtëpisë

së tij ose në të njëjtën rrugë? Mirëpo, profeti Muhamed a.s., siç e shohim nga ky rast, nuk ka menduar ashtu. Taberaniu shënon nga shoku i Pejgamberit a.s., Ka'b bin Malik, se si në një rast te profeti Muhamed a.s. kishte ardhur dikush dhe i kishte thënë:

"O i Dërguari i Allahut, unë banoj në mëhallën e Benu-filanit, por nga banorët e saj nuk jam i qetë. Pejgamberi a.s. menjëherë dërgoi Ebu Bekrin, Omerin dhe Aliun r.a., të cilët shkuan dhe qëndruan në dyer të xhamisë në Medine dhe thirrën: O njerëz! Nga dyzet shtëpi (në të katër anët e shtëpisë suaj) konsiderohen fqinjë. Nuk ka për të hyrë në Xhenet ai nga e keqa e të cilit frikësohet fqinji i tij."

Edhe Aishja r.a. thotë se e ka dëgjuar nga Muhamedi a.s.: "Fqinjë konsiderohen dyzet shtëpi".

Myslimani është i detyruar që jetën e tij ta përshtatë sipas rregullave të Kur'anit të Madhërishëm, ngase ato janë garancia më e sigurt për të qenë i lumtur në të dy jetët.

Gjithashtu myslimani është i detyruar në çdo moment të mendojë për Allahun xh.sh. dhe Atij t'i drejtohet për ta mbrojtur nga ato fatkeqësi dhe preokupime që nuk mund të mbrohet vetë pa mëshirën e Allahut xh.sh. Përveç të tjerash, jemi të detyruar t'i lutemi Allahut xh.sh. për të na ruajtur nga e keqja dhe fqinji i keq, i cili mund të na e bëjë jetën të hidhur, sepse ka njerëz që nuk i respektojnë as ligjet njerëzore, as ligjet hyjnore. Andaj duhet t'i drejtohemi Allahut xh.sh. për të na mbrojtur nga e keqja e njerëzve të tillë.

Ebu Hurejra tregon se profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Lutjuni Allahut që t'ju mbrojë nga tri gjëra: Nga fqinji i keq, i cili kur sheh tek ti ndonjë të mirë, e fsheh, ndërsa kur sheh ndonjë të keqe, e përhap atë. Nga gruaja e keqe, e cila e ofendon dhe e kritikon burrin kur i vjen në shtëpi, ndërsa kur nuk është aty e tradhton. Dhe nga udhëheqësi që nuk ta pranon rregullsinë dhe vlefshmërinë në punë, ndërsa, nëse rastësisht gabon diçka, nuk ta fal atë."

Se cilat janë obligimet e fqinjit ndaj fqinjit, i shohim nga hadithet që na transmeton Ebu Hurejra r.a., në të cilat Muhamedi a.s. ka thënë:

"Kush i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, le të respektojë e le të kujdeset për fqinjin e tij (duke u sjellë mirë me të dhe duke i bërë mirë)".

Kur Muhamedi a.s. i tha fjalët e

lartpërmendura, shokët që ishin të pranishëm, e pyetën: "O i Dërguari i Zotit, cilat janë obligimet e fqinjit ndaj fqinjit?" Ai iu përgjigj:

- Nëse të kërkon diçka për t'i dhënë, t'ia japësh.
- Nëse kërkon për t'i ndihmuar, ta ndihmosh.
- Nëse kërkon për t'i dhënë hua, t'i japësh.
- Nëse sëmuret, ta vizitosh.
- Nëse i ndodh ndonjë pikëllim a fatkeqësi, t'i shprehësh keqardhje dhe ngushëllime.
- Nëse vdes, ta përcjellësh deri në varr (kuptohet duke ia falur edhe xhenazen).

Marrëdhëniet e mira ndaj fqinjëve janë kusht i lumturisë në këtë botë, çfarë kuptohet vetvetiu, sepse aty ku mbretëron zilia, ngatërresa, inati, aty nuk ka paqe e as lumturi.

Sot kemi një numër të madh njerëzish, madje edhe familjesh që për vite jetojnë në shtëpi të ngjitura, ose në një shtëpi, dhe shpesh njëri-tjetrit të mos i dinë as emrin, e jo më të takohen e të nderohen mes tyre.

Profeti Muhamed a.s. në një rast ka thënë:

"Kush beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit, le të flasë atë që është e dobishme ose le të heshtë. Kush beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit, le ta nderojë fqinjin e tij. Kush beson në Zotin dhe në Ditën e Gjykimit, le ta mirëpresë dhe ta nderojë mysafirin e tij".

Muhamedi a.s. nuk e konsideron një mysliman për besimtar të drejtë e të sinqertë, nëse fqinji i tij nuk është i sigurt se ai nuk do t'i shkaktojë qoftë ndonjë dëm moral ose material. Buhariu transmeton një hadith ku Muhamedi a.s. në një rast u ka thënë shokëve të tij tri herë:

"Pasha Allahun, nuk është besimtar (i vërtetë)." Një nga të pranishmit i tha: "Qoftë i mallkuar, po kush është ai, o i dërguar i Zotit?" Muhamedi a.s. i tha: "Ai nga dëmet dhe të këqijat e të cilit nuk janë të sigurt fqinjët e tij".

Muslimi shënon hadithin e profetit Muhamed a.s. i cili ka thënë:

"Nuk do të hyjë në Xhenet (pa u ndëshkuar) ai nga zullumi i të cilit nuk është i sigurt fqinji i tij".

Duke e ditur se sa mëkat është shqetësimi në çfarëdo mënyre i fqinjit të vet, Muhamedi a.s. në një rast ka thënë:

"Mos e shqetëso fqinjin as me erën (aromën) e gjellës sate, nëse nuk je në gjendje t'i japësh diçka prej saj. Mos e ndërto shtëpinë lart, nëse ia zë dritën apo frymën, e ai nuk pajtohet me këtë".

Edhe atëherë kur myslimanin e vërtetë e ofendon ose e shqetëson dikush, ai nuk duhet t'ia kthejë njëlloj. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: "Nuk mund të barazohet e mira me të keqen. Largoje (të keqen) me atë që është më e mirë, dhe atëherë ai me të cilin ke pasur armiqësi, do të jetë mik i dashur. Këtë nuk mund ta arrijë askush përveç atyre që bëjnë durim dhe këtë nuk mund ta arrijë askush përveç atyre që kanë pjesë të madhe (në virtyte dhe në përsosmëri shpirtërore)". (Fussilet, 34-35)

Në kuptimin e ajeteve të cituar edhe Muhamedi a.s. i këshillon shokët e vet të mos e kthenin të keqen me të keqe. Tregohet se një njeri kishte ardhur te profeti Muhamed a.s. dhe ishte ankuar ndaj fqinjit të vet, e ai i kishte thënë:

"Mos e shqetëso me asgjë edhe nëse ai të shqetëson ty, bëhu i durueshëm, mos reago. Mjafton që do t'ju ndajë vdekja".

Shtrohet pyetja: A e kemi obligim ta ndihmojmë fqinjin edhe materialisht?

Po e kemi obligim ta ndihmojmë me aq sa kemi mundësi, mirëpo ka pasur raste, ka edhe sot, që një mysliman të jetojë në bollëk,







ndërsa fqinji i tij të mos ketë kushte për të plotësuar as nevojat më elementare jetësore. Për myslimanët e tillë i dashuri ynë, Muhamedi a.s., ka thënë:

"Nuk është besimtar (i vërtetë) ai që fle i ngopur, kurse fqinji i tij është i uritur".

Enes bin Maliku thotë se në një rast Muhamedi a.s. ka thënë:

"Në Ditën e Gjykimit fqinji do t'i varet në qafë fqinjit të vet dhe do t'i thotë: O Zot! Këtij vëllait tim i ke dhënë gjithçka, unë kam rënë (në gjumë) i uritur e ai ka rënë i ngopur. Pyete o Zot, pse ma ka mbyllur derën e tij dhe pse nuk më ka ndihmuar nga ato (të mira) që ia ke dhënë Ti?"

Çdo mysliman duhet që ta ketë parasysh se për qenë i lumtur e i qetë edhe atij i duhet ndihma e Zotit xh.sh., kurse Zoti xh.sh. ndihmon robtë e Tij aq sa i ndihmojnë ata nevojtarët.

Ebu Hurejra r.a. tregon se Muhamedi a.s. ka thënë: "Ndihma e Zotit vjen sipas lartësisë së bamirësisë materiale të njeriut ndaj tjetrit".

Ndër veprat më të mira është edhe pajtimi i personave të përçarë, pajtimi i fqinjëve të ngatërruar. Ebu Hurejra r.a. tregon se Muhamedi a.s. ka thënë:

"Nuk ka vepër më të mirë sesa falja (me rregull) e namazeve dhe pajtimi i dy myslimanëve të përçarë."

Edhe Allahu xh.sh. na ka urdhëruar të pajtojmë vëllezërit tanë.

Allahu xh.sh. në Kur'anin e Madhërishëm thotë:

"Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër. Pajtoni ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar". (Huxhurat, 10)

Profeti Muhamed a.s. na porosit gjithashtu për të pajtuar personat e përçarë. Ebu Umame tregon se Pejagamberi a.s. ka thënë: "Udhëto një milje e vizito të sëmurin, udhëto dy milje e pajto dy vetë, udhëto tri milje dhe vizito mikun në emër të Allahut".

Dhe në fund po e përfundojmë me hadithin e Pejgamberit a.s. ku na porosit:

"Bëhuni të moralshëm, atëherë edhe gratë tuaja do të jenë të ndershme e të moralshme. Silluni mirë ndaj prindërve tuaj, se edhe fëmijët tuaj do të sillen mirë ndaj jush. Ai të cilit i drejtohet i vëllai me lutje duke i kërkuar falje për ofendimin që i ka bërë, e nuk ia pranon, ai nuk do t'i afrohet kroit tim (Haudi-t Keuther)".

Sikur vetëm ta dinin?

E pyetën njëherë Nastradinin: "Sa e madhe është bota?" Ndërkohë pranë tyre kalonte një kortezh varrimi. Duke treguar për nga i vdekuri Nastradini u përgjigj: "Pyeteni më mirë atë. Ai sapo e mati."

Sa kut është bota? Është kaq e vogël saqë me gjithë përpjekjet s'na e nxë as trishtimin, as lumturinë; as brengën, as ngadhënjimin. Nuk na e nxë as rendjen tonë në ekzistencë, e cila zbehet, shuhet deri në fikje. Të gjitha ngelen sërish brenda nesh si një makth apo si një dritë. Jashtë botës që ndërtojmë përbrenda, në botën e dukshme nuk ka asgjë që mbetet.

Koha në të bëhet e pakapshme. Rrëshqet duke na lënë të habitur me duart e zgjatura për të ndalur ikjen. Zbrazëtia na i tkurr ëndrrat që vdesin përditë. Jetët tona, një skenar i trishtuar, lavdi të heshtura në kufijtë e botës, që priren të mblidhen derisa nuk e sheh më dhe vdekja të vjen. Atëherë sytë zgjerohen dhe e thithin në gropa të tmerruara; rini e bukuri e tretur në plakje e shëmti, pasuri e humbur në mangësi të përhershme, gjallëri e brejtur nga sëmundja e brenga, fundi-lot i hidhur për atë që ishte dhe nuk ishte nën kapak të rëndë.

Kjo botë nuk është amshim. Botën e madhe të njeriut nuk mund ta nxërë. Ato takohen tangjent me njëra-tjetrën për t'u njohur me vetveten dhe rrëshqasin tutje, duke mos u ndeshur kurrë më. Atëherë sytë zgjerohen dhe thithin në gropa të tmerruara këtë njohje për t'u lexuar njëherë në sprovën brenda varrit dhe për t'u rilexuar në sprovën e rëndë të Ditës së Gjykimit.

Nga Sehl b. Sadi r.a. transmetohet se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Sikur kjo botë tek Allahu të vlente sa një krah i mushkonjës, prej saj jobesimtarit nuk do t'i lejonte të shijonte as edhe një pikë ujë."

Uji i kësaj bote nuk e shuan etjen. Ai e shton atë dhe mallin për freskinë. A e shuan uji i saj etjen e varrit? Sa kut është ajo për të shuar flakët e përtëritshme të Xhehenemit? Është kufi i ngushtë ku vërtitesh dhe të mbyt angështia për të dalë, për t'ia dalë me shpirtin. Gjithçka që na shkruhet është bota që ndërtojmë përbrenda; makth apo dritë. Makthi na mbledh në frikë dhe dhembje, ndërsa drita na i hap kufijtë drejt përjetësisë.

Le t'i pyesim të vdekurit tanë për të vërtetat e tyre. Ata flasin me atë që ka vdekur brenda nesh, me kohën që iku bashkë me ta. Ata flasin me vdekjen tonë të përditshme që na zhurmon si një zile alarmi dhe na thërret në jetë. Jeta është me të Përjetshmin. Shpresa buron nga Shpresëdhënësi. Kjo dynja është e errët dhe e zjarrmuar si një farkë për të mençurin, i cili punon në të çelësin që ia hap dyert për t'u kthyer tek Allahu në siguri. Dyert e

Xhehenemit janë vetë të hapura. Ai thërret: "A ka më?" Thërret të pakujdesshmit. Ata që i zgjeruan kufijtë e dynjasë me sytë e mendjet e tyre dhe shkanë jashtë, në gropat e zjarrit.

Le t'i pyesim të vdekurit tanë se çfarë kanë lënë pas dhe çfarë gjetën! Ata flasin me hijet e emrave të tyre të harruara, me gëzimin e lotët e tharë regjistruar në kujtesë të padukshme.

Ata flasin me kumbimin e frikës së përhershme që na e përcjell i njëjti fat. Të gjithë jemi të përcaktuar me vdekje, me harrim prej kësaj bote dhe siguria e përhershmërisë na është premtuar vetëm në ahiret. "Jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos dëfrim e lojë, ndërsa vetëm ajo botë është jetë, sikur vetëm ta dinin." (Ankebut: 64)

Sytë tanë tashmë janë të hapur për këtë botë e të mbyllur për jetën tjetër. Ajo mundet të na joshë e të na kërcënojë, sepse e prekim me dorë lëvozhgën e saj. Duhet kurajë ta shtrëngojmë e ta thyejmë për të zbuluar boshësinë. Prandaj e përcjellim vdekjen, prandaj e kujtojmë, prandaj e ndiejmë... dhe mundemi ta matim botën. Tani që është ende herët. Tani që provimi s'ka mbaruar dhe përgjigja ka kohë. Duke përcjellë të vdekurit dhe dëgjuar fjalët e tyre të pazëshme. Duke fërkuar sytë dhe ardhur në vete. Sikur të vinim në vete sa më parë! Vdekja diku afër na pret, se bota është shumë e vogël për të qenë ajo larg. Shpejt vjen dita kur gjithçka merr vlerën e vet të vërtetë. Duke udhëtuar për në atë jetë, sigurisht do ta mësojmë madhësinë dhe vlerën e dynjasë. Dhe do të përgjigjemi për masën që dikur patëm zgjedhur.

"Jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos dëfrim e lojë, ndërsa vetëm ajo botë është jetë, sikur vetëm ta dinin!" (Ankebut: 64)

Hasan Selami

ALLAHU, XH.SH., NË KURAN E KA LIDHUR ALKOOLIN DHE BIXHOZIN ME ARMIQËSI DHE URREJTJE, NDËRSA SHKENCA BASHKËKOHORE E KA ZBULUAR FSHEHTËSINË E KËSAJ LIDHJE

Allahu i Madhëruar në Kuranin fisnik urdhëron e thotë:

"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.

Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?"

(El - Maide, 90-91)

Studimet më të reja të paraqitura në revistën "Scientific American" (tetor, 2013), kanë zbuluar që bixhozi ka veprim të njëjtë në tru sikurse alkooli dhe drogat.

Në tru ekziston sistemi apo qendra e cila quhet "qendra për shpërblim", e cila prodhon sasi të caktuara të dopaminës, ndërsa dopamina është neurotransmetues i cili i ofron njeriut ndjenjën e kënaqësisë, euforisë dhe gëzimit.

Kur njeriu luan bixhoz, truri i tij tajon dhjetë herë më tepër dopaminë dhe i jep ndjenjën e kënaqësisë (ngjashëm me ndjenjën e kënaqësisë gjatë marrëdhënies intime, si dhe sikurse gjatë marrjes së drogës apo pijeve dehëse në përgjithësi). Por, kur truri tajon sasi të mëdha të këtyre substancave, kjo shkakton ngarkesë të qelizave të trurit, shkatërrim të një pjesë të kësaj qendre të trurit dhe vie deri tek humbja e vetëkontrollit.

Me kohë edhe me humbjen e vetëkontrollit zhvillohet sjellje agresive ndaj tjerëve.

Shkencëtarët vërtetuan që droga dhe bixhozi shkaktojnë ndryshime të përhershme në regjionet specifike të trurit në të njëjtën mënyrë në regjionet e njëjta, d.m.th. kanë efekt të njëjtë.

Pikërisht, studimi i kryer në Universitetin "Yale" në vitin 2003, si dhe studimi i kryer në vitin 2012 në Universitetin e Amsterdamit vërtetojnë që aktiviteti elektrik i trurit zvogëlohet dhe vie deri tek çrregullimi në "qendrën për shpërblim", ndërsa veprimet serioze dhe pasojat paraqiten në pjesën paraballore (korteksi paraballor i trurit), ndërsa ky regjion është përgjegjës për vlerësimin e riskut dhe mënjanimin e instiktit dhe lakmisë, gjegjësisht për planifikimin dhe lëvizjen e veprimeve të mira dhe të këqija.

Varësit e drogave, bixhozit dhe alkoolit njëjtë kanë sjellje agresive ndaj tjerëve, për shkak të çrregullimit në këtë regjion të trurit.

Prandaj, e vërteta shkencore të cilën shkencëtarët në mënyrë ilustrative e kanë paraqitur, tregon se si gjërat dehëse të të gjitha llojeve (të gjitha llojet e drogave dhe gjithë llojet e alkoolit dhe opiateve) e kanë të njëjtin ndikim në tru: agresivitet dhe dhunë ndaj tjerëve, urrejtje ndaj tjerëve, dhunë në familje ndaj fëmijëve dhe bashkëshorteve, si dhe shkatërrim të qelizave në regjionin paraballor të trurit. Të gjitha këto janë pasoja të rrezikshme që shkatërrojnë individin dhe familjen.

Sot, disa shkencëtarë besojnë që veprimi negativ i bixhoz it në tru mund të zgjat 24 orë, mu sikurse efekti i drogave dhe alkoolit. Truri i bixhozçiut është i lëkundur dhe i harxhuar dhe tek personat e tillë ekzistojnë shumë çrregullime sikurse tajimi abnormal i dopaminës dhe probleme tjera.

Eksperti i bixhozit, Christopher Welsh nga Maryland, njëri nga destinacionet më të njohura të bixhozit, ka thënë: "Imazhi i trurit të skenuar të varësit nga bixhozi duket shumë i ngjashëm me trurin e varësit të drogave."

Kurani paralajmëron në rrezikun e pijeve dehëse dhe të bixhozit dhe i përmend në kontekst të njëjtë.

Për këtë, të mendojmë mirë për versetet të cilat me subtilitet dhe me stil mahnitës i drejtohen mendjes dhe zemrës së njeriut njëkohësisht:

"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.

Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?"

(El - Maide, 90-91)

| RASIM VRIONI |

Ndjenja e jetës së përtejme në ndërgjegje

Njeriu mbi këtë planet të quajtur "tokë", i ka ditët të numëruara, por megjithatë dëshira për të jetuar është një dëshirë natyrale që personi e ka qysh nga lindja. Dëshirat e tij materiale janë të pafundme, ndërsa planet e pakufizuara i bën duke llogaritur se do jetojë gjatë.

Por megjithatë vjen një ditë dhe njeriu vdes. Vdes duke lënë pas të gjitha planet, llogaritë, familjen, miqtë, mungesën e të cilëve e ndiente dhe në ndarjen më të shkurtër. Po pas kësaj ndarjeje (vdekjes), a ka vallë një ritakim?

Kur njeriu hedh sytë dhe sheh atë që e rrethon, sheh se e "mira" dhe e "keqja", janë në përleshje me njëra-tjetrën. Sheh luftën midis të lartës dhe të ulëtës, duke e vlerësuar sipas besimit të tij. Sheh se e keqja është përhapur kudo, dhe se përfaqësuesit e saj dalin fitimtarë në shumicën e rasteve. Nuk arrin të shohë njerëzit që të shpërblehen për atë që kanë punuar. Ikën, largohet nga jeta, pa arritur të shohë fundin e së mirës dhe së keqes.

Njeriu, kur jeton sipas ligjeve të xhunglës ose në fëmijëri, nuk habitet nga një përfundim i tillë. Ai nuk arrin të kuptojë se, nëse punët ecin në këtë rrugë atëherë ka mangësi dhe rrezik, sepse në këtë periudhë njeriu pranon se sundimi dhe superioriteti i takojnë më të fortit, se e drejta për të jetuar i takon atij që del fitimtar.

Por, kur ndërgjegjja e njeriut fillon të zgjohet dhe kur bëhet më tolerant dhe e shikon jetën me tjetër sy, mërzitet kur mendon se nuk do të vijë një ditë kur e mira të triumfojë mbi të keqen.

Ai e kupton se pas besimit në një Zot, i Cili gjykon në bazë të drejtësisë dhe sundon po në bazë të drejtësisë, është i detyruar të besojë në parimin: "E mira shpërblehet dhe e keqja ndëshkohet."

Njeriu e kupton se nëse ky parim nuk realizohet në këtë jetë, në një jetë tjetër duhet të realizohet patjetër.

Fundi i racës njerëzore, që gjallëron sipërfaqen e rruzullit tokësor, ndërton, riparon, e bën me mijëra punë të tjera, a nuk ka asnjë ndryshim me fundin e një buburreci apo të një zvarraniku?

Jeto si të mundësh, merr sa të mundësh, shijo e dëfrehu sa të mundësh në një jetë të kufizuar...

Një pjesëz jete ku as edhe një gjë nuk do të realizohet siç duam ne, plotësisht...

E më pas kthimi në hiç i çdo gjëje, e barabartë me përjetësinë. Por, për njeriun që mendon dhe që dëgjon zërin e ndërgjegjes, një koncept i tillë i jetës është abstrakt dhe i paimagjinueshëm. Njeriu nuk mund të kënaqet me një koncept të tillë mbi jetën, duke menduar se do të ketë një përfundim të tillë, kaq të thjeshtë.

Jo, njeriu nuk mund ta pranojë këtë mendim.

Ndërgjegjja zgjohet dhe fillon ta ngacmojë njeriun. Duke menduar ai bindet për ekzistencën e botës së përtejme. Ai kupton vlerën e jetës dhe bëhet i ndërgjegjshëm për rëndësinë e saj.

Kupton se sa lart qëndron njeriu, kupton se ç'është raca njerëzore, nderin, krenarinë dhe superioritetin e saj mbi llojet e tjera. Kupton se forcat natyrore në gjithësi nuk duhet ta shtyjnë të bëjë plane të gabuara dhe se jeta nuk mbaron me vdekjen... Më pas tek ai rizgjohet ndërgjegjja dhe fiton ndjenjën e drejtësisë.

Arrin të kuptojë ndryshimin midis një fundi të thjeshtë e të rëndomtë si dhe një fundi që e çon drejt lumturisë së përhershme.

Hafiz Qazim Ismaili

(1889-1968)

MYFTI NË VLORË DHE TIRANË

Ndër figurat më të skalitura në qytetin e Vlorës është edhe portreti dhe emri i Hafiz Qazim Ismailit.

Hafiz Qazim Ismaili ka lindur në Vlorë në mars të vitit 1889 dhe ka ndërruar jetë në Tiranë në mars të vitit 1968.

Pasi kishte kryer studimet në Medresenë e Lartë të Stambollit, u emërua fillimisht si imam i xhamisë së Plumbit në Vlorë. Ndërkohë ka shërbyer si mësues i gjuhës shqipe në shkollën e Muradies (afër Sheshit të Flamurit), duke pasur si kolegë zotërinjtë Jorgji Ceka, Musa Muho e Zeqir Harremi dhe si drejtor z. Gani Dizdari.

Ai ka qenë pjesëmarrës në ngritjen e flamurit në Vlorë në vitin 1912. Ishte njohës i tri gjuhë të huaja: turqisht, arabisht dhe italisht. Duke qenë njohës i mirë i gjuhëve arabe dhe turke, ka dhënë një ndihmesë të madhe në përkthimin e librave dhe materialeve të tjera me përmbajtje fetare. Kështu, në bashkëpunim me një shok të tijin, përktheu Mevludi Sherifin nga osmanishtja në shqip.

Duke qenë mësues i fesë në Vlorë, gjatë gjithë kohës ku është lejuar dhënia e saj, ai ka kontribuar në pajisjen e nxënësve të tij me kulturë fetare islame. Edhe sot, shumë vlonjatë të moshuar shprehen se i ndjeri Hafiz Qazimi ka qenë mësuesi i tyre dhe dijet i kanë përvetësuar nga ai.

Ai ka qenë gjithashtu hartues i librit "Vjersha besimi" ku ka himne e ilahi të ndryshme që edhe sot dihen e këndohen.

Një libër me vlerë është edhe "Përmbledhje lutjesh që mbahen në ceremonitë fetare e festat kombëtare", hartuar nga Hafiz Qazim Ismaili, imam i xhamisë "Tabak" në Vlorë dhe shtypur në shtypshkronjën "Atdheu" në Vlorë në vitin 1936.

Siç thuhet edhe në parathënien e këtij libri, autori ka pasur për qëllim që t'i shërbejë më së miri fesë e të ndihmojë me këtë rast në shqipërimin e lutjeve islame në ceremonitë fetare dhe kombëtare. Lexuesi në këtë libër, ka të përcaktuar mirë e qartë lutjet, duke u nisur nga lindja e Profetit, lutjen e pasbukës, synetllëkut, lutjet e hytbes, të hatmes, kur këndohet Kur'an, lutje me rastin e festave kombëtare dhe përfundon me lutjen e kurbanit.

Duke qenë imam i xhamisë kryesore të asaj kohe, "Tabak", me kulturë e dije të plotë islame, ai ka shkruar edhe në revistat kryesore të kohës. Kështu, në revistën "Zani i Naltë" (dhjetor 1933 - janar 1934, nr. 4 e 59), në artikullin "Vlera e diturisë e pozita e gruas në fenë islame", flet për mendimet e Profetit për diturinë, citon suren El Alak, flet për filozofët islamë Gazaliun, Raziun, Xhyrxhaniun, etj. Është për t'u përmendur mendimi se drejtësia e urtësia vihen në veprim kur dihen detyrat fetare, shoqërore e njerëzore. Me një fjalë duhet të jesh i ditur që të zbatohen edhe këto virtyte. Ai kundërshton abuzimin ndaj porosive fetare rreth të nderuarit të të drejtave të gruas dhe godet thëniet e pabaza ndaj fesë, e cila prej më se 14 shekujsh e ka shpëtuar gruan prej kthetrave të robërimit dhe i ka garantuar të drejta të barabarta me burrin.

Në revistën "Zani i Naltë", tetor 1932, në artikullin "Nderi i shërbimit ushtarak", ai shprehet se sipas fesë islame, atdheu, nderi, familja, shpirti, pasuria e një populli mbrohet e sigurohet vetëm me anë të shërbimit ushtarak. Ai u bën thirrje për kryerjen e shërbimit ushtarak, duke cituar suren El Adijatë dhe thëniet e Profetit (a.s.) për këtë rast.

Po në këtë revistë, në tetor-nëntor 1930, flitet për dy virtytet më të mëdha: adhurimin e Allahut dhe nderimin e respektimin ndaj krijesave të Tij.

Populli mysliman i Vlorës e njeh Hafiz Qazim Ismailin edhe si predikues të temave të rëndësishme fetare në ditët e xhuma dhe të festave të bajrameve, si dhe drejtues të faljeve dhe predikues gjatë ditëve të madhnueshme të muajit të Ramazanit.

Duke marrë parasysh ndershmërinë, aftësinë dhe prirjet demokratike, ai u emërua kryemyfti i zonës së Vlorës dhe më vonë i asaj të Tiranës. Të gjitha detyrat e dhëna ai i ka kryer më së miri dhe për këtë janë dëshmitarë besimtarët, të cilët edhe sot e kësaj dite e kujtojnë me respekt të veçantë emrin e tij.

Ai ishte bashkëkohës dhe kishte miqësi me: Hafiz Abdulla Dizdarin (myderriz shumë i dashur dhe i nderuar), Hafiz Adil Isufin, që me zërin e tij të ëmbël bënte për vete gjithë besimtarët, si dhe ish myftiun e Vlorës, Haxhi Ismail Hakiun (i ati i Imam Vehbi Ismailit).

LUMTURIA

1. Lumturia gjithnjë duket e vogël kur e posedon në duart e tua, mirëpo kur e lë të ik, menjëherë e kupton se sa ajo ishte madhështore dhe e shtrenjtë!

2. Çelësi i lumturisë është të ëndërrojmë, kurse çelësi i suksesit është të bëjmë që këto ëndrra të realizohen!

3. Gjysmën e lumturisë e gjen në një shpirt që të kupton dhe gjysmën tjetër në një zemër që të ndien!

4. Nga shkaqet e lumturisë është që ta rikujton njeriu atë që e posedon nga begatitë, para se të ta rikujtojë se çfarë ka nga problemet dhe mërzitë!

5. E duan lumturinë, mirëpo ata nuk i përulen Allahut në namaz!!

6. Lumturi është që t'i posedosh tri gjëra: Atë që e punon, atë që e do dhe atë që e synon!

7. Një prej shkaqeve më të thjeshta të lumturisë është përmendja e Allahut!

8. Nëse hulumton pas lumturisë, fillimisht hulumtoje brenda teje!

9. Lumturinë e ndien ai që e pastron fytyrën e tij nga brengat, kokën e tij nga problemet dhe trupin e tij nga dhembjet!

10. Nëse e do lumturinë, atëherë duaje për vëllanë tënd atë që e do për veten!

11. Hasan El-Basrij, Allahu e mëshiroftë, u pyet se cilën ditë e ke festë?! "Çdo ditë që në të nuk i bëj mëkat Allahut, për mua është festë" – tha.

12. Prej shkaqeve të lumturisë është të posedosh sy i cili e sheh më të bukurën, zemër e cila e fal më të keqen, mendje e cila e mendon më të mirën dhe shpirt që e mbush shpresa!

13. Kush vdes duke qenë Allahu i kënaqur me të, ky është i vetmi përfundim i lumtur dhe s'ka tjetër përveç tij.

14. Zgjedh të jesh i buzëqeshur!

15. Prej shkaqeve të qetësisë shpirtërore është istigfari i vazhdueshëm.

16. Nëse njeriu bën më tepër istigfar (kërkimfalje) sesa që ankohet, do ta gjejë rehatinë para se të ankohet!

17. Lumturia ka fshehtësi dhe më e rëndësishmja është istigfari.

PYETJET E NJË ATEISTI DHE PËRGJIGJET E IMAM EBU HANIFES



Një njeri erdhi tek imam Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë, dhe i tha:
– O ti imam, a e ke parë Zotin tënd?
Imami iu përgjigj:
– Jo.
Njeriu i tha:
– A e ke dëgjuar Zotin tënd?
Imami iu përgjigj:
– Jo.
– A e ke prekur Zotin tënd? – e pyeti njeriu.
– Jo, – u përgjigj imami.
– A e ke perceptuar Zotin tënd?
– Jo, – i tha përsëri.
Njeriu i tha:
– Po atëherë si i beson Zotin tënd, kur nuk e ke parë, nuk e ke dëgjuar, as që e ke prekur e perceptuar?!
Imam Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë!, e pyeti:
– Po ti, a e ke parë mendjen tënde?
Njeriu iu përgjigj:
– Jo.
– Po a e ke dëgjuar mendjen tënde?
– Jo, – tha ai.
– A e ke prekur mendjen tënde?
– Jo.
– A e ke perceptuar mendjen tënde?
– Jo
Atëherë imami i tha:
– Po ti a ke mend apo je budalla?
Njeriu iu përgjigj:
– Jo, jam me mend.
– E ku është mendja jote? – e pyeti imami.
– Mendja është prezent dhe ekziston, – iu përgjigj njeriu.
Imam Ebu Hanife, Allahu e mëshiroftë!, i tha:
– E pra, edhe Allahu është prezent dhe ekziston!

| NADIA LIKA |

Edukata familjare

Edukata familjare është një edukim themelor. Kush nuk ka mundur të marrë edukimin e duhur në familjen e tij, atë nuk mund ta plotësojë as një studim e edukim tjetër. Lind pyetja, kush mund ta japë këtë edukim kaq të vlefshëm për jetën e secilit prej nesh?

Gruaja, Nëna

- Mëshira – mëshira e tyre është një ndjenjë shumë e madhe, që nuk pret fare shpërblim.

Për shembull, një nënë për të shpëtuar fëmijën e saj, pa shpresuar fare për shpërblim, sakrifikon jetën. Me një sakrificë të vërtetë dhe sublime, ajo vetëflijohet dhe bëhet "kurban" për fëmijën e saj. Po të lulëzojë kjo cilësi e tyre, ato do të shpëtojnë në të dy jetët, por si rrjedhojë e problemeve dhe vështirësive të ndryshme, pengohet te gratë kjo cilësi e të qenët nënë dhe koha i shtyn ato drejt abuzimeve.

Një nënë fisnike, e cila e edukon fëmijën e vet vetëm që ta shpëtojë nga rreziqet e kësaj jete, i merr parasysh të gjitha vështirësitë, vetëm e vetëm që t'i garantojë fëmijës jetën e përkohshme. Që t'i bëhet djali, ta zëmë oficer, të gjithë mallin e shpenzon dhe e heq nga një shkollë që krahas lëndëve të përgjithshme, përfshin edhe edukimin fetar siç janë medresetë, për ta dërguar në ndonjë program studimi në Evropë. Kështu, ajo synon t'i përmirësojë atij jetën e kësaj bote, por mjerisht i rrezikon premisat për rregullimin e fryteve për në botën tjetër. Njeriu duhet ta dijë mirë se jeta është e shkurtër, punët e vlefshme janë të shumta, por edhe punët e kota janë të shumta, kësisoj duhet një baraspeshim midis vlerës së kësaj bote, si edhe botës së përtejme, duke u fokusuar te besimi dhe feja, morali dhe edukata, të cilat, nëse fëmija i hulumton, do të gjejë dituri të dobishme në to.

Dituria shkencore dhe filozofike që individi mund të ketë në bagazhin e tij të dijes, duhet t'u lërë vendin bindjeve dhe arsyetimeve që, duke iu lutur Zotit xh.sh., dijet e tij të kthehen dhe të bëhen të dobishme.

A nuk e kupton njeriu, se duke mohuar të mirat e Zotit dhe dijet fetare, po vihet kundër mëshirës që e ka ndjekur atë në çdo hap të krijimit të tij. Po qe se nëna nuk mundet ta ushqejë fëmijën me dashurinë dhe edukatën fetare, ky i fundit do të mbetet i paditur ndaj çështjeve fetare. Për këtë ndërhyrje anormale, fëmija do t'i kërkojë llogari nënës, përse ajo nuk e ka edukuar që t'i përulet ligjeve të Krijuesit, duke i thënë: "vetë e ke fajin, sepse nuk më ke forcuar besimin, por më zhyte në këto rreziqe, kësisoj, ai vazhdimisht do të ankohet, ngaqë nuk e ka marrë edukatën e duhur të fesë Islame. Në këtë jetë nuk do t'i kushtojë rëndësi mëshirës së nënës dhe ndoshta do të bëjë shumë gabime ndaj saj.

Në qoftë se nëna e përdor aftësinë prindërore me mëshirën që ka ndaj fëmijës së saj, për ta shpëtuar nga rruga e mosbesimit dhe e mëkateve, atëherë nëna bëhet pjesë e të gjitha sevapeve që fëmija i saj do të bëjë në jetë. Ky fëmijë, në botën e ahiretit, nuk do të bëhet paditës i saj por me gjithë shpirt do të bëhet një ndërmjetës për mirë për nënën e tij.

Mësuesi i fëmijës, edukatori më ndikues, është nëna e tij. Pra në qoftë se nënat nuk e shpërdorojnë mëshirën dhe sinqeritetin që u ka hije, ato nuk duhet të bëjnë abuzime me fëmijët e tyre për t'i orientuar për keq fëmijët, se ajo jetë e kaluar në përpjekje dhe mund për ta edukuar fëmijën, për nënën është me vlerën e një arke të mbushur plot e përplot me diamante. Nga ana e kundërt, duke ia kthyer vëmendjen fëmijës vetëm nga kjo botë e përkohshme, e cila, ndaj asaj tjetrës, të përtejshmes, është si

thërrmijë qelqi, atëherë do të ishte një "abuzim" i mëshirës së saj, që ja ka dhuruar Krijuesi për fëmijën e pamëkate.

Ankesa për jetën familjare

Familja është vend-mbrojtja për secilin njeri, veçanërisht jeta familjare e myslimanëve është si një lloj parajse e vogël. Nga studimet që i janë bërë kësaj çështjeje, është arritur në përfundimin se shfrenimi dhe përhapja e veseve të rinisë, i jep dëm fesë Islame dhe e prish jetën shoqërore të myslimanëve. Femrat e pakujdesshme, lakuriqësia e grave të paturpshme dhe të shfrenuara, dëmton imazhin dhe sprovon jetën e përditshme të besimtarëve.

Said Nursi na këshillon: "O motrat e mia dhe ju o bijtë e mi, mund të ruhen cilësi brilante vetëm atëherë kur të keni marrë edukatën e përshtatshme të fesë Islame. Një burrë i mençur nuk duhet t'i sakrifikojë ndjenjat dhe dëshirat te gruaja e tij, vetëm për kënaqësitë e dhjetë viteve të kësaj bote, ta dini se hijeshia më e bukur e grave është në moralin e tyre të brendshëm dhe te mëshira e tyre e veçantë. Këto cilësi të bukura ata i vazhdojnë deri në përjetësi. Mundohuni t'i frenoni dëshirat tuaja, të përcaktoni cilësitë e vyera të grave tuaja të lejuara."

Për besimtarët, shoqëria me gratë nuk është vetëm për një jetë të shkurtër të kësaj bote, por ndoshta edhe për jetën e përjetshme, ku do të ketë shoqëri përrallore. Tani, nën maskën e kulturës dhe qytetërimit të sotëm, pas një akti primitiv, që është nevojë te kafshët, çiftet po ndahen përjetësisht, duke u përballur me një shkatërrim total të jetës familjare.

Është fatbardhë ai burrë, i cili, për të mos e humbur bashkëshorten e vet në jetën e përjetshme, e ndjek gruan që është e mirë me punët e ahiretit, sipas parimeve të fesë islame, duke u bërë në këtë mënyrë edhe vetë një mysliman i mirë. Po kështu është fatbardhë edhe ajo grua e cila ka pasur fatin të martohet me një burrë që përjeton fenë Islame dhe përpiqet për të mos e humbur kënaqësinë e jetës së përjetshme. Ajo, duke ndjekur burrin e vet, kthehet në një myslimane të mirë, që brenda kënaqësive të kësaj jete, e fiton edhe parajsën e lumtur. Sa fatzi është ai burrë që imiton gruan e vet në rrugën e mëkateve dhe nuk mundohet fare për ta penguar atë, duke e nxirë jetën akoma më shumë. Po ashtu edhe kjo grua vetë është po aq fatzezë, që është martuar me një burrë të tillë, që stimulon ligësitë e rrugës së mëkateve, duke i parë këto veprime në një formë tjetër, ajo e kopjon atë. Mjerë ato çifte që së bashku me njëri-tjetrin bashkëpunojnë për

të hyrë në thellësinë e zjarrit, duke u shtyrë drejt "qytetërimit" të shfrenuar.

Lumturia e jetës familjare dhe kënaqësia e kësaj jete dhe e jetës tjetër është kur shfaqen cilësitë e vlefshme të gruas. Kështu, ndërtesa e kësaj familjeje shkatërrohet nga themelet. Në këto raste, duhet që gruaja të tregohet e kujdesshme, ta frenojë burrin e vet, duke e përmirësuar atë, në mënyrë që ta shpëtojë nga rruga e mëkateve ku ka rënë. Po qe se gjërat kërkon t'i zgjidhë me inat dhe demaskon duke bërë të njëjtin gabim, atëherë më shumë se askujt, ajo i bën dëm vetes. Dihet se kush e shkel besnikërinë, në këtë jetë merr dënimin e merituar.

Gratë heroike me shpirt të madh, në pikëpamje të sakrificës dhe mëshirës fisnike, i tejkalojnë burrat e tyre. Krijuesi, në qenien e tyre ka vendosur veti dhe aftësi nga ku buron morali i pastër, në jetën familjare, e sidomos nëse gratë janë të mbrujtura me moralin e Fesë Islame, ato janë jo vetëm gjysma e racës njerëzore, por edhe vetë nënat e llojit njerëzor.

O motrat e mia, është shumë më mirë për ju të jeni të kursyera dhe nikoqire të mira, ashtu siç jeni krijuar që kur keni lindur. Më mirë të punoni si gratë e fshatit për të nxjerrë bukën e gojës, se sa të hyni nën sundimin e një burri mizor, i cili e ka bërë si moto të jetës së vet, paturpësinë.

Mos u nënshtroni dhe mos u pajtoni me këta njerëz të rrezikshëm. Po qe se iu ka rënë fati të jeni martuar me një burrë problematik, që nuk pajtohet me sjelljet e mira, mos synoni menjëherë ndarjen prej tij (vetëm nëse situata i tejkalon caqet e vendosura sipas dispozitave të jurisprudencës), por vazhdoni sjelljen tuaj të hijshme me durim. Dashtë Zoti, këto veti tuajat do ta sjellin bashkëshortin tuaj në rrugë të mbarë.

Duhet të bindemi se qejfet dhe kënaqësitë e hallallit janë të mjaftueshme për njeriun. Në shtëpitë tuaja, bisedoni me fëmijën me butësi dhe do të jeni njëqind herë më të kënaqura se sa ta shkoni kohën tuaj kot para ekraneve të televizorëve, duke ndjekur telenovela e programe çedukuese.

Në përjetimin e fesë islame dhe në besimin te rruga dhe ligjet e Allahut do të ndjeni kënaqësi të mëdha shpirtërore, e në rrugën e mosbesimit dhe të mëkatit, edhe në jetën e shkurtër, do t'iu shkaktohen hidhërime dhe dhimbje të mëdha.

Kush e mban farën e besimit në vetvete, dashtë Allahu ka fituar Xhenetin edhe në këtë jetë. Kush nuk e ka mbjellë farën në shpirtin e tij, ai ka hedhur hapa të sigurta në rrugën që të shpie në Xhehenem që e ndëshkon njeriun në të dy jetët me hidhërime të panumërta.

| TUGRAL CAGRI YAVUZ |

Këmba

NJË KRYEVEPËR INXHINIERIE

Këmba është një gjymtyrë së cilës nuk i jepet shumë rëndësi kur krahasohet me organet e tjera vitale siç janë truri apo zemra. Sidoqoftë, këmba është një strukturë shumë komplekse mekanike që është e përbërë nga 26 kocka, 33 artikulacione dhe më shumë se 100 muskuj e ligamente. Rreth një e katërta e eshtrave në trupin e njeriut dhe rreth një e pesta e artikulacioneve gjenden në dy këmbët tona. Kjo është arsyeja pse Leonardo da Vinçi e përshkroi këmbën njerëzore si një kryevepër inxhinierie dhe artistike.

Një person i shëndetshëm bën rreth 5,000 hapa në ditë. Duke pasur një jetë mesatarisht prej tetëdhjetë vjetësh, një person bën rreth 150 milion hapa gjatë gjithë jetës së tij. Duke supozuar se çdo hap është 75 cm, një person ecën rreth 110,000 kilometra gjatë gjithë jetës së tij. Kjo korrespondon me ecjen përgjatë ekuatorit rreth 3 herë. Përveç kësaj, një person tipik qëndron në këmbë rreth 2-4 orë në ditë. Gjatë gjithë këtyre veprimtarive, këmba e njeriut mbart peshën e tërë trupit. Në pozicionin ngritur, pesha e trupit mbështetet nga dy këmbët, ndërsa aktivitete të tilla si ecja dhe vrapimi bëhen vetëm nga një këmbë për një periudhë të caktuar kohe. Ndërsa qëndrojnë në këmbë, këmbët mbajnë 100% të peshës së trupit të tyre, ndërsa ecin, kjo normë rritet deri në 150%. Ndërsa ecni, këmba që duhet të ngrihet nga toka afrohet përsëri në tokë me një nxitim në të njëjtin drejtim si graviteti. Prandaj, forca e ndikimit në momentin kur këmba prek tokën korrespondon me 150% të peshës trupore të një personi. Në rastet e aktiviteteve të rënda siç janë vrapimi dhe kërcimi, kjo forcë rritet lehtësisht deri në 5 herë peshën e trupit dhe, te disa persona, deri në 10 herë. Për një person që peshon 70 kilogramë, kjo forcë mund të jetë 105 kg (ose rreth 1050 Newton) në ecje dhe lehtësisht 350 kg (ose rreth 3500 Newton) në vrapim ose kërcim. Duke supozuar se një person që ecën për një orë bën 5,000 hapa, këmba tërheq gjithsej rreth 500 tonë ngarkesë (5,000 hapa x 105 kg). Në vrapim, kjo shifër do të rritet përafërsisht tre herë.

Këmba është krijuar me një projekt të mrekullueshëm mekanik dhe ndërtimor që është në gjendje të mbajë vazhdimisht ngarkesa të tilla të mëdha. Kockave dhe muskujve të këmbës i shtohen dy modele brezash të ndryshëm. Njëri prej tyre, struktura e quajtur brezi gjatësor fillon nga kocka e thembrës (calcaneus) dhe përfundon me kockat e saj metatarsale. Disa studiues pohojnë se harku i gjatë është i ndarë në dy pjesë si harku i brendshëm (harku medial) dhe harku i jashtëm (harku lateral). Sidoqoftë, të dyja strukturat ngjajnë me urat e ndërtuara në harqe. Harku i dytë në këmbë quhet harku transversal. Ky brez është pingul me brezin e gjatë nga ana e djathtë e këmbës në anën e majtë dhe është më i shkurtër në gjatësi. Prandaj, këmba është një strukturë e mrekullueshme që përbëhet nga afërsisht dy harqe. Kjo strukturë e këmbës mund të krahasohet me

urat me harqe ose një digë. Struktura e harkut njihet si struktura më e fortë kundër ngarkesave të pjerrëta në zonat e ndërtimit për shkak të qëndrueshmërisë së modeleve kundër forcave të kompresimit në rastet e ngarkesës vertikale. Prandaj, digat hidroelektrike ndërtohen në formën e harqeve për ta bërë modelin më rezistent ndaj presionit hidrostatik.

Struktura e harkut të këmbës është shumë fleksibël dhe gjithashtu mund të lëvizë lart e poshtë si një amortizator makine dhe vepron si një përthithës i tronditjeve. Nëse nuk do të kishte një strukturë të tillë, forcat e ndikimit, gjatë aktivitetit fizik në këmbë dhe vrapim, do të ishin më të larta dhe do të shkaktonin dhimbje kronike në këmbë. Komplikacioni i shputës së sheshtë është rezultat i një dëmtimi në strukturën e harkut të këmbës që vjen nga lindja ose zhvillohet më pas. Pacientët me shputë të sheshtë shpesh nuk janë në gjendje të kryejnë aktivitete afatgjata në kohë dhe pësojnë dhimbje në këmbë, si dhe komplikacione në organet e tjera të trupit.

Struktura e harkut të këmbëve tona nuk është i vetmi faktor i përfshirë në përthithjen e goditjes që krijohet nga forcat mekanike. Shtresa e dhjamit në pjesën e poshtme të këmbës gjithashtu kontribuon në këtë proces. Në një person të shëndetshëm, kjo shtresë dhjamore, e cila ka një lartësi prej 2.5 cm nën thembër, bie në 5-7 mm në pjesën e përparme të këmbës. Ajo ndihmon gjithashtu në shpërndarjen në mënyrë të barabartë të forcave vertikale dhe horizontale të shkaktuara nga qëndrimi ose ecja në pjesën e poshtme të këmbës. Në të njëjtën kohë, shërben si burim i izolimit të nxehtësisë dhe ndihmon në mbrojtjen e këmbëve tona nga sipërfaqet e nxehta ose të ftohta. Në disa sëmundje të tilla si diabeti, në të cilat kjo shtresë e dhjamit shkrihet ose zvogëlohet, mund të zhvillohen plagët e quajtura ulcera këmbësh, sepse përthithja e shokut dhe shpërndarja e ngarkesës dëmtohen. Presioni mekanik llogaritet duke e ndarë sasinë e forcës mekanike sipas sipërfaqes në të cilën është aplikuar, që do të thotë se zonat me sipërfaqe më të vogla i nënshtrohen më shumë presionit. Kjo është arsyeja pse gjilpërat shumë të holla, pavarësisht se peshojnë pothuajse asgjë, mund të shpojnë lëkurën tonë dhe të shkaktojnë dhimbje. Në mënyrë të ngjashme, dëmtimi i shtresës së dhjamit nën këmbë bën që forcat e aplikuara të veprojnë në një zonë të kufizuar. Për shembull, zvogëlimi i dhjamit në zonën nën kokat e eshtrave metatarsal, zvogëlon efektin "jastëk" në këtë zonë dhe shkakton një presion në vlera të larta. Ky presion shtesë mund të shkaktojë dëmtim të indeve së bashku me ulcerat e lartpërmendura të këmbës.

Një situatë e tillë që do të shkaktojë dhimbje te një person normal nuk mund të ndihet nga shumë diabetikë. Nëse diabeti nuk kontrollohet mirë, neuropatia ose "mungesa e ndjesisë" mund të ndodhë si një ndërlikim. Qelizat nervore të vdekura bëhen të paafta të ndiejnë dhimbje, gjë që mund të rezultojë në atë që njerëzit të mos dinë për dëmin që po i bëhet trupit të tyre. Pacientët me diabet që zhvillojnë neuropati nuk do të ndiejnë dëmtime të shtresës dhjamore dhe shoqërojnë vlera të presionit të lartë, ndërsa normalisht do të ishte një presion tipik. Ulcerat e patrajtuara të këmbëve mund të infektohen dhe mund të kthehen në gangrenë. Meqenëse këmba gangrenoze duhet të pritet, diabeti për fat të keq shkakton një numër të madh të amputimeve. Amputime të tilla janë për fat të keq mjaft të shpeshta në të gjithë botën për shkak të neuropatisë diabetike. Dr Paul Brand, i cili studioi ulcerat diabetike të këmbëve, e përcaktoi dhimbjen si një dhuratë nga Zoti që askush nuk e dëshironte. Ndonjëherë, ajo që nuk na pëlqen mund të jetë më e mirë për ne (Kur'an 2: 216); në të njëjtën mënyrë, dhimbja mund të shkaktojë shumë telashe te njerëzit, por gjithashtu mund të na paralajmërojë për rreziqe dhe dëme për trupin tonë.

Kështu, kujdesi për këmbët është shumë i rëndësishëm te diabetikët. Tri veprimet e mëposhtme u rekomandohen pacientëve, kontrolli ditor i këmbës, larje ditore dhe kontrolli i brendshëm i këpucëve. Defekte të këpucës, guralecë të vegjël në këpucë që mund të jenë shumë të dëmshëm për diabetikët me humbje të ndjesisë. Nga ana tjetër, kur një objekt i tillë i fortë mbetet në këpucë, pacientët mund të shkelin mbi to në mënyrë të përsëritur pa e ndjerë atë, gjë që ka të ngjarë të çojë në një rast ulcere.

Me dhimbjen që funksionon si një alarm shëndetësor, ngarkesa të jashtëzakonshme mekanike që mbart, izolimi i nxehtësisë dhe tiparet përthithëse të goditjes, e bëjnë këmbën e njeriut një mrekulli të artit hyjnor që bën thirrje për një soditje mahnitëse.

Përktheu: Erion Sukaj

GJYSHE, ÇKA ËSHTË KURANI?

- Gjyshe, çka është Kurani?

– Ah, biri im, kjo pyetje nuk është e lehtë për t'u përgjigjur.

– Shiko, biri im, kur e kemi blerë lavatriçen tonë, së bashku me të e kemi marrë edhe një libër udhëzimi i cili është dashur të lexohet para se të fillojhej përdorimi i pajisjes.. Nëna jote, biri im, për ta përdorur makinën e larjes së rrobave, është dashur t'u përmbahet rregullave të fletës me udhëzime. A është ashtu?

– Po, gjyshe, patjetër.

– Çfarë do kishte ndodhur po ta ndiznim lavatriçen pa mos i lexuar udhëzimet?

– Makina do të prishej.

– Për ta përdorur si duhet kompjuterin, fillimisht duhet lexuar librin që vjen me të, apo jo?

– Po, ai është libër i cili të mëson si ta përdorësh kompjuterin, mirëpo gjyshe pse m'i tregon këto të gjitha?! A e di se çfarë të pyeta? Të pyeta se çfarë është ky libër që quhet Kuran?

– Hëm! Bëj pak durim, biri im. Unë në fakt po i përgjigjem pyetjes tënde.

– Atëherë mirë, gjyshe, por po i bie pak si gjatë.

– Këtë kompjuter e shpikën dhe e prodhuan njerëzit, inxhinierët, punëtorët. Po kush e krijoi njeriun?

– Allahu i Madhëruar, gjyshe.

– Ashtu është! E sheh se sa vlerë ka libri udhëzues për kompjuterin. Si mendon, A duhet dhe a ka vlerë një libër që është për udhëzimin e njerëzve?

– Më trego, gjyshe!

– Po, po, biri im i mençur! Ka!

– Hajde më trego se kush ia krijoi njeriut dorën, zemrën, syrin!

– Allahu i Madhëruar.

– Kush është më i vlefshëm, njeriu apo kompjuteri?

– Njeriu.

– Mrekullueshëm! Unë nuk e jap birin tim as për gjithë kompjuterët e botës! Si mundet që njeriu të dijë se si ta përdorë dorën e tij, syrin, zemrën? Mendo pak, biri im! Rikujtoje pyetjen tënde që ma parashtrove në fillim!

– Po, e di! Ai është Kurani.

– Po, biri im. Kurani është libër, udhëzim për njerëzimin. Ashtu siç i duhet çdo makine një libër udhëzimi që tregon se si përdoret, gjithashtu edhe njeriu ka nevojë për udhëzim. Njeriu nuk mundet të jetojë si duhet nëse nuk e mëson dhe nuk e ndjek Kuranin.

– Tani që e more përgjigjen e pyetjes tënde, më trego se çfarë do t'i ndodhë njeriut nëse nuk e mëson dhe nuk e ndjek Kuranin?

– Do të shkatërrohet!

– Ashtu është, biri im, njeriu do të shkatërrohet.

MOS E ZEMËRO ATË QË E KE MË TË SHTRENJTË

E zemëroi nënën e vet dhe i thonte vetes "nesër do të sillem mirë me të", mirëpo ajo ndërroi jetë para se të vjen e nesërmja, dhe mbeti dhembja dhe pikëllimi në gjoksin e tij.

–Doli nga shtëpia pasiqë e zemëroi gruan, edhe pse një "fjalë dhe përqafim" do ishte e mjaftueshme që të shkrihet kjo pengesë mes tyre, mirëpo ajo u inatos dhe e refuzoi një gjë të tillë, e pastaj tha: mirë, kur të kthehet do të kërkoj prej tij një gjë të tillë, mirëpo caktimi i i Allahut ishte që ai të dilte,e të mos kthehej më!

E mbylli derën e hyrjes me fuqi dhe doli shpejt që ti bashkëngjitet shokëve duke e lënë pas vete prindin, i cili edhe përskaj asaj se e la të vetëm, mërzitej për të se ku do të shkojë dhe çfarë do ti ndodhë... dhe në momentet e kulmit të dëfrimit të tij dhe angazhimit me shokë, ia sjellën në celular dhe i thanë: Allahu e mëshiroftë prindin tënd, ndërroi jetë! Prindi i tij i ndërroi jetë, kurse ai shumë vonë u zgjua nga gjumi!

– Kështillë për mua... dhe për ju.. dhe për të gjithë ata që kanë zemër dhe ndërgjegje:

"Mos e zemëro atë që e ke më të shtrenjtë, e pastaj ta vonosh të kënaqurit e tij deri të nesërmen".

BOTIMET KMSH

MUND TA GJENI PRANË LIBRARISË “MIQTË E IIBRIT”

BOTIM I RI



ILMIHAL PËR FILLESTARË

Ilmihali, është dituria që tregon dhe shpjegon çështjet në lidhje me besimin, adhurimin dhe moralin, të cilat duhet t’i dijë çdo mysliman. I dërguari i Allahut (a.s.) thotë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo mysliman”. Dituria për të cilën Profeti ynë (s.a.s.) bën fjalë, fillimisht është Ilmihali. Çdo besimtar dhe besimtare e ka detyrë së paku të nxërë njohuritë themelore për jetën adhurimore dhe të njohë detyrimet e veta fetare.